

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, (e vendosur ne objektin e Degës së Kësaj Gjykate në Vushtrri), si kontestimore e përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të paditësit: Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës të cilën e përfaqëson e Divizioni për Përfaqësime, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati shtetëror kundër të paditurit nga Mitrovica, baza e kontestit: Pasurim i Pa Bazë, në seancën e datës: **24.11.2016**, konform nenit 148 të LPK-së bjen këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**- në bazë të pohimit -**

**I.OBLIGOHET** i padituri që në emër të pasurimit të pa bazë, t'ia paguaj paditëses Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, shumën prej 112 euro, në llogarinë rrjedhëse me numër të M.P.M.S-së, brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**II.OBLIGOHET** i padituri që në emër të taksës për padi t'ia paguaj paditëses shumën prej 15 euro të gjitha këto në afat 7 ditor nga dita e pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**III. OBLIGOHET** i padituri në emër të taksës për vendim të ia paguaj gjykatës shumën prej 15 euro brenda afatit 7 ditor nga dita e pranimit të aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja me datë: 29.06.2015 ka parashtruar në gjykatë padi kundër të paditurit.

Gjykata ka mbajtur seancën me datë: 24.11.2016. në të cilën prezantuan të dy palët.

Në këtë seancë pala paditëse deklaroi: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë për kthimin e mjeteve të pensionit bazë në kundërshtim me normat pozitive në R e Kosovës përkatësisht në kundërshtim me dispozitat e nenit 2 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ nr.14/2009 për ndalesat e pensionit bazë në rast kur përfituesi i të drejtës së pensionit ndërron jetë, për faktin se padia dhe kërkesëpadia ka disa gabime teknike prandaj jemi të gatshëm që të

bëjmë përmirësimin e tyre përkatësisht precizimin e kërkesëpadisë, ku shumën duhet të jete 112 euro si ne objekt te padis e jo 270 euro siq është në petitumin e padisë, e po ashtu edhe pjesa që ka të bëjë me paragrafin e 2 te referatit te padis, ku përmendet Komuna e Gjakovës, është lëshuar gabim sepse nuk ka të bëjë me rastin konkret pasi që në rastin konkret kompetente është Qendra Rajonale Departamenti i Mitrovicës.

I padituri në seancë deklaroi se: është e vërtet se të hollat të cilat ceken-shumën prej 112 euro I kam tërhequr duke mos e ditur se nuk kam të drejtë për shkak se konsideroi se Ministria është dashtë zyrtarisht mos me bërë transferin e parave pas vdekjes se pensionistit, unë nuk e kam ditur se duhet ta lajmëroi për vdekjen, mirëpo jam i gatshëm që shumën ta kthej.

Gjykata vlerësoi se pohimi i kërkesëpadisë nuk është në kundërshtim me nenin 3.3 të LPK-së, i njëjti është në pajtim edhe me provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës dhe pas shqyrtimit të mëtejme në procesverbal në prezencën e palëve ndërgjyqëse mori aktgjykim në bazë të pohimit.

Andaj duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICE,**  
**C.nr. 382/2015 Më dt. 24.11.2016.**

**GJYQTARI,**  
**Faton Ademi**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit nëpërmjet kësaj gjykate.